



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 151

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM TË
POLITIKAVE ZHVILLIMORE PËR FINANCA PUBLIKE DHE RITJE
TË QËNDRUESHME, NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM TË
POLITIKAVE ZHVILLIMORE PËR FINANCA PUBLIKE DHE RITJE
TË QËNDRUESHME, NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Nëpërmjet këtij Ligji ratifikohet Marrëveshja për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 3
Dokumentet e bashkangjitura

Në shtojcën e këtij Ligji është i bashkangjitur teksti i Marrëveshjes për Financim të Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe rritje të qëndrueshme, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-151
28 korrik 2022

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës